



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I GJEOGRAFISË



**PROGRAMI I DISIPLINËS**

**PSIKOLOGJI EDUKIMI**

**DREJTIMI: MËSUESI**

<i>Pedagogu:</i>	<i>Prof.Dr. Nikoleta Mita</i>
<i>Ngarkesa:</i>	<i>6 ETCS (3 leksione dhe 1 seminar në javë)</i>
<i>Frekuenca :</i>	<i>45 leksione 15 seminare</i>
<i>Lloji i lëndës:</i>	<i>E detyrueshme</i>
<i>Programi i studimit :</i>	<i>Master Mësuesi</i>
<i>Viti/Semestri:</i>	<i>I/I</i>

Lënda ka karakter modular dhe është e përbërë nga tre module, moduli i psikologjisë së zhvillimit, moduli i të nxënësve dhe moduli i vlerësimit të nxënësve.

**MODULI: PSIKOLOGJI ZHVILLIMI**

**Shkurtesë:** Ky modul ka për qëllim që të njohë studentët me karakteristikat më të rëndësishme të zhvillimit kognitiv, fizik dhe psikosocial në fëmijërinë e mesme dhe adoleshencë dhe kohështrirja e tij është në pesë javë.

**Temat e leksioneve**

1. Zhvillimi fizik dhe kognitiv në fëmijërinë e mesme
2. Pikëpamja e Piazhës: Karakteristikat e stadit të operacioneve konkrete
3. Zhvillimi psikosocial në fëmijërinë e mesme
4. Zhvillimi i arsytimit moral sipas Piazhës dhe Kohlbergut
5. Koncepti i shoqërisë tek fëmijët dhe adoleshentët

**Forma e kontrollit dhe vlerësimi**

<i>Prezenca e tij fizike dhe shkalla e aktivizimit të tij në diskutimet gjatë seminareve</i>	<i>10 %</i>
<i>Detyra e kursit</i>	<i>20 %</i>
<i>Provimi përfundimtar</i>	<i>70 %</i>
<i>Gjithsej:</i>	<i>100 %</i>

**Shënim:** Ky modul mbulon 34 % të vlerësimit të të gjithë disiplinës.

**Literatura bazë**

1 Karaj, Th., (2000). *Psikologjia e zhvillimit të fëmijës* Tirane, Emal

**Literatura ndihmëse**

1. Richard M. Lerner ,Francine Jacobs,Donald Wertlieb (2003) handbook of applied developmental science , volume 1, Sage Publications,Inc

## MODULI: TEORITË E TË NXËNIT

**Shkurtesë:** Qëllimi i kësaj lënde është njohja me teoritë më të vlefshme të të nxënësve përsa i përket rëndësisë së tyre historike dhe aplikative në sistemet arsimore botërore. Këto perspektiva teorike për vite me radhë kanë influencuar konceptimin, hartimin dhe zbatimin e aktiviteteve, shërbimeve dhe politikave arsimore në mbarë botën.

### Temat e leksioneve

1. Të nxënësve - përshkrim i përgjithshëm. Nga spekulimi në shkencë. Nxënësi, shkolla dhe potenciali për të nxënë.
2. Teorite bihevisoriste. Kushtëzimi operant. Kushtëzimi klasik i Pavlov. Teoria e fqinjësisë e Guthrie-t. Pikëpamja e Skinnerit. Parimet e kushtëzimit operant.
3. Të nxënësve kognitiv. Piaze dhe stadet e të nxënësve. Bandura, Gagne, Ausubel dhe të nxënësve social kognitiv. Te nxënësve nëpërmjet vëzhgimit. Eksperimenti i Bandurës.
4. Teoritë humaniste. Analizimi i teorive të Maslou dhe Rogers dhe influenca e tyre.
5. Konstruktivizmi dhe evolucioni i teorive postmoderne. Kuadri filozofik i konstruktivizmit.

### Forma e kontrollit dhe vlerësimi

#### *Pjesëmarrja dhe aktivizimi*

Studentit kërkohet frekuentim i rregullt, pa bërë mungesa ose shumë pak mungesa të justifikuar. Ai/ajo duhet të dorëzojë detyrat e kursit brenda afatit të caktuar. Leximet dhe përgjigjet në seminare: studentët duhet t'i përfundojnë leximet e përcaktuara para secilës orë në auditor. Përfitimi prej leximit do të tregohet me dy mënyra: me përgjigje të orientuara dhe të lira. Studentëve mund t'u kërkohet që të japin përgjigje me shkrim pas leximit të detyruar dhe përpara orës së mësimi për të qenë të përgatitur rreth diskutimit në klasë.

Ky element i kontrollit dhe vlerësimit të dijeve përbën 10 % të vlerësimit përfundimtar.

#### *Punimi/studimi përfundimtar*

Gjatë kursit studentët në mënyrë individuale do të përgatitin një studim rasti të një personi për të nxënësit e tij/saj, si dhe të reflektojnë për mundësitë e përmirësimit të procesit të të nxënësve bazuar në stilin e tyre të preferuar. Të jetë punë e pavarur me përmbajtje të qartë dhe pa plagjiaturë. Punimi të shprehet me gjuhë të qartë, logjike dhe me argumente bindëse. Në punim kandidati të përligjë zgjedhjen e temës dhe të vërtetojë origjinalitetin e punimit. Ai/ajo duhet të tregojë në mënyrë bindëse se e ka përvetësuar plotësisht temën që trajton, duke pasqyruar në të konceptet bazë teorikë që janë dhënë në leksione dhe seminare. Punimi me shkrim duhet të shkruhet sipas normave të shqipes letrare dhe atyre akademike. Kjo detyrë përbën 20 % të pikëve. Vonesa në dorëzimin e detyrës penalizohet me pikë. Detyra do të prezantohet në mënyrë individuale përpara kolegëve, që përmban 20% të pikëve

#### *Detyrë në grup*

Dy-tre studentë do të përfaqësojnë një nga figurat që ka vendosur pikë themeli në teoritë e të nxënësve. Vlerësimi është 10%

#### *Provimi*

Provimi i fundit dhe vlerësimi përfundimtar. Provimi do të mbulojë temat e trajtuara në leksione, në lexime e diskutime gjatë kursit. Qëllimim parësor i provimit është t'i ndihmojë studentët të sintetizojnë dhe të integrojnë ato çka kanë studiuar. Provimi do të përfshijë elementët teorikë dhe praktikë të trajtuar gjatë semestrit në këtë lëndë, që përmban 40% të pikëve.

Prezenca e tij fizike dhe shkalla e aktivizimit të tij në

diskutimet gjatë seminareve

10 pikë

Punimi përfundimtar

20 pikë

Detyra në grup

10 pikë

Provimi përfundimtar

60 pikë

Gjithsej:

100 pikë

**Shënim:** Ky modul mbulon 33 % të vlerësimit të të gjithë disiplinës.

**Literatura bazë**

Sula, G. “Të nxënësit – nga teoria në praktikë”, Bota shqiptare, 2015

**Literatura ndihmëse**

Wolfolk, A. “Psikologji edukimi”, CDE 2011

Tamo, A.; Karaj, Th., Rrapti, E., Orhani, Z. “Mësimdhënia dhe të nxënësit”, 2005

**MODULI: VLERËSIMI I NXËNËSIT**

**Shkurtesë:** Moduli është e destinuar për studimet Master Profesional në Mësuesi. Ky modul është e organizuar në mënyrë koncize dhe përfshihen tema të cilat trajtojnë bazat e matjes dhe të vlerësimit në arsim. Gjithashtu jepen njohuri për instrumentet e matjes për vlerësimin e nxënësit. Nga shumëllojshmëria e këtyre instrumentave janë veçuar testet objektive dhe subjektive. Në kontekstin e formimit të studentëve si vlerësues jepen dhe njohuritë kryesore për mbledhjen, dhe raportimin e rezultateve të nxënësve dhe vlerësimin e mësimdhënies.

**Temat e leksioneve**

1. Kuptimi dhe planifikimi i matjes dhe vlerësimit.
2. Ndërtimi dhe përdorimi i testeve objektive dhe subjektive
3. Vlerësimi i testeve dhe i punimeve të nxënësve.
4. Regjistrimi, interpretimi i të dhënave të matjeve dhe raportimi i vlerësimit.
5. Vlerësimi i mësuesit dhe mësimdhënies.

**Forma e kontrollit dhe vlerësimi**

*Prezenca e tij fizike dhe shkalla e aktivizimit të tij në diskutimet gjatë seminareve* 15 %

*Detyra e kursit* 25 %

*Provimi përfundimtar* 60 %

*Gjithsej:* 100 %

**Shënim:** Ky modul mbulon 33 % të vlerësimit të të gjithë disiplinës.

**Literatura bazë**

Mita, Nikoleta: Vlerësimi i nxënësit, Tiranë 2013

**Literatura ndihmëse**

1. Buletini: Vlerësimi në arsim, botim i ISP.
2. Callahan, F. Joseph & Clark, H. Leonard: Teaching in the Middle and Secondary Schools, Planning for Competence, Third Edition, Macmillan Publishing Company, USA, 1988, p. 337-365, 366-401. (Ndodhet në Bibliotekën e FSHS)

**Shënim:** Nota përfundimtare në këtë lëndë del si rezultat i mbledhjes së pikëve të marra në të gjitha modulet. Pikët konvertohen në nota sipas skemës së miratuar nga Departamenti i Pedagogjisë dhe i Psikologjisë.

**SISTEMI I VLERËSIMIT**

Shkalla e pikëve	Nota numerike	Përshkrimi i notës	Nota me shkronja sipas ECTS
91 – 100	10	Shkëlqyeshëm	A

81 – 90	9	Shumë mire	B
71 – 80	8	Mirë	C
61 – 70	7	Kënaqshëm	D
51 – 60	6	Mjaftueshëm	D
41 – 50	5	Kalueshëm	E
– 40	3, 2, 1	Mbetës	F

**Miratoi**

**Përgjegjësi i Departamentit**

**Prof.Dr. Romeo HANXHARI**

*Tiranë, 2016*